

**AKT THEMELIMI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“N.E.D.D” SH.P.K**

Në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, sot me dt. 11.08.2022 (dy mijë e njëzet e dy), me vullnet të lirë, ortakët:

**Z.Sokol Zaimi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 29.11.1980, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I01129039V email: [sokolzaimi80@yahoo.it](mailto:sokolzaimi80@yahoo.it);

dhe

**Z.Artur Zaimi**, shtetas shqiptar, lindur në Gramsh, më 14.06.1975, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me nr. personal H50614039J, email: [arturzaimi75@gmail.com](mailto:arturzaimi75@gmail.com).

vendosën të themelojnë këtë shoqëri sipas kushteve të përcaktuara në këtë Akt Themelimi me përmbajtjen si vijon:

**NENI 1  
DATA E THEMELIT**

1. Sot, më datë 11.08.2022 (dy mijë e njëzet e dy), themeluesit vendosën të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “N.E.D.D” SHPK.

**NENI 2  
FORMA E SHOQËRISË**

1. Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3  
EMËRTIMI**

1. Emri i plotë i shoqërisë është “N.E.D.D” SHPK.

**NENI 4  
SELIA**

1. Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: **Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga 3 Vëllezërit Kondi, Godina nr. 10, Tiranë.**

2. Me miratim te organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

## NENI 5 KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.
2. Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim te Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

1. Shoqëria “N.E.D.D” SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

*Hotel, bar-kafe, shërbime katering dhe restorant, import - eksport dhe tregtimi i mallrave të ndryshme industriale dhe ushqimore, elektronike, pajisje elektro shtëpiake, kancelari, shitje detergjentësh dhe shërbime pastrimi. Tregti me pakice të karburanteve, naftës dhe nën produkteve të saj si gaz i lëngshëm, vajra etj. Shërbime konsulence juridike, agjenci turistike, guida turistike, transport udhëtarësh dhe mallrash dhe çdo veprimtari tjetër ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.*

## NENI 7 KAPITALI

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është njëqind (100.00) Lekë, i përbërë nga dy (2) kuota të zotëruara nga ortakët si vijon:

**Z.Sokol Zaimi, zotërues i 49% (dyzetë e nëntë përqind) të kapitalit të shoqërisë N.E.D.D SHPK të përbërë nga një (1) kuotë.**

**Z.Artur Zaimi zotërues i 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë N.E.D.D SHPK të përbërë nga një (1) kuotë.**

## NENI 8 ADMINISTRATORI




1. **Administratori i parë i shoqërisë N.E.D.D SHPK do të jetë: Artur Zaimi**, shtetas shqiptar, lindur në Gramsh, më 14.06.1975, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me nr. personal H50614039J, email: [arturzaimi@gmail.com](mailto:arturzaimi@gmail.com).
2. Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**NENI 9**  
**DISPOZITA E FUNDIT**

1. Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.
2. Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.
3. Autorizohet Administratori për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**THEMELUES**

**SOKOL ZAIMI**



**ARTUR ZAIMI**

